



DREJTORIA E SHERBIMEVE DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

ANALIZË E RISKUT INSTITUCIONAL, OPERACIONAL DHE MJEDISOR NË RAST TË MOSSIGURIMIT TË SHËRBIMIT TË PRANIMIT, PESHIMIT DHE DEPOZITIMIT FINAL TË MBETJEVE URBANE

1. QËLLIMI I ANALIZËS

Kjo analizë hartohet me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e risqeve institucionale, operacionale, mjedisore, financiare dhe ligjore që mund të lindin si pasojë e mosgarantimit të shërbimit të pranimit, peshimit, regjistrimit dhe depozitimit final të mbetjeve urbane të gjeneruara në territorin administrativ të Bashkisë Krujë.

Shërbimi i trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve përbën hallkën përfundimtare të zinxhirit të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe ndërprerja e tij cenon drejtpërdrejt funksionimin normal të sistemit publik të menaxhimit të mbetjeve.

2. RISKU OPERACIONAL DHE I VAZHDIMËSISË SË SHËRBIMIT

Në kushtet e mungesës së një operatori ekonomik që disponon infrastrukturë të autorizuar për pranimin dhe depozitimin final të mbetjeve, Bashkia Krujë përballet me risk të lartë operacional që konsiston në:

Ndërprerjen e zinxhirit logjistik të menaxhimit të mbetjeve

- Pamundësinë për shkarkimin e fluksit ditor të mbetjeve urbane
- Mbingarkimin e pikave të grumbullimit dhe stacioneve të transferimit
- Krijimin e stokut të pakontrolluar të mbetjeve
- Cenimin e vazhdimësisë së shërbimit publik ndaj qytetarëve.

Duke marrë në konsideratë sasinë mesatare vjetore prej rreth 21,000 ton mbetje urbane, çdo ndërprerje e shërbimit krijon efekt të menjëhershëm në kapacitetet operacionale të bashkisë dhe në aftësinë për menaxhimin e flukseve ditore të mbetjeve.

3. RISKU TEKNIK DHE I MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS

Mosdisponimi i një strukture të autorizuar për depozitimin final sjell:

- Mungesë të kapaciteteve pritëse për mbetjet e gjeneruara
- Humbje të gjurmueshmërisë së fluksit të mbetjeve
- Pamundësi për realizimin e procesit të peshimit dhe monitorimit sasior
- Mungesë të dokumentimit teknik dhe administrativ të sasisë së depozituar
- Cenim të sistemit të raportimit institucional.

Gjithashtu krijohet risk për depozitime të përkohshme jashtë parametrave teknikë dhe mjedisorë të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

4. RISKU MJEDISOR

Ndërprerja e depozitimit final në një strukturë të licencuar dhe të monitoruar mjedisor paraqet risk të konsiderueshëm për:

- Ndotjen e tokës
- Ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Gjenerimin e lixiviateve të pakontrolluara
- Emetimin e gazeve nga dekompozimi i mbetjeve
- Krijimin e vatrave të ndotjes mjedisore.

Mbetjet urbane të paadministruara sipas standardeve teknike përbëjnë burim potencial të degradimit të mjedisit dhe cenimit të objektivave kombëtare të menaxhimit të mbetjeve.

5. RISKU PËR SHËNDETIN PUBLIK

Akumulimi i mbetjeve jashtë sistemeve të kontrolluara të depozitimit favorizon:

- Zhvillimin e vektorëve biologjikë
- Shtimin e popullatave të brejtësve dhe insekteve
- Përhapjen e mikroorganizmave patogjenë
- Krijimin e kushteve me risk të lartë sanitar.

Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe rrit ekspozimin e popullsisë ndaj problematikave shëndetësore.

6. RISKU LIGJOR DHE I PËRPUTHSHMËRISË

Mosgarantimi i depozitimit final të mbetjeve ekspozon Bashkinë Krujë ndaj:

- Konstatimeve nga organet e auditimit dhe kontrollit
- Procedurave administrative nga autoritetet kompetente
- Evidentimit të mosushtrimit të funksioneve ligjore të deleguara me ligj
- Pretendimeve të palëve të treta për dëme të shkaktuara nga mosfrimi i shërbimit.

Gjithashtu krijohet risk për mospërmbushjen e objektivave të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe të detyrimeve institucionale që rrjedhin nga legjislacioni sektorial.

7. RISKU FINANCIAR DHE EKONOMIK

Në rast të mosrealizimit të këtij shërbimi, Bashkia Krujë mund të përballet me:

- Rritje të kostove operative emergjente
- Nevojë për ndërhyrje të jashtëzakonshme
- Kosto shtesë transporti dhe administrimi
- Dëme ekonomike në sektorin e turizmit dhe biznesit lokal
- Ekspozim ndaj penalteteve dhe detyrimeve financiare të paparashikuara.

Menaxhimi emergjent i krizave të mbetjeve rezulton në mënyrë të vazhdueshme më i kushtueshëm se ofrimi normal dhe i planifikuar i shërbimit.

8. RISKU REPUTACIONAL DHE INSTITUCIONAL

Mosfunksionimi i sistemit të depozitimit final të mbetjeve dëmton besueshmërinë institucionale të Bashkisë Krujë dhe krijon perceptim negativ tek qytetarët, institucionet qendrore, partnerët ndërkombëtarë dhe subjektet ekonomike që operojnë në territor.

Për më tepër, duke qenë se Bashkia Krujë përfaqëson një nga destinacionet kryesore turistike dhe historike të vendit, çdo situatë e lidhur me grumbullimin e pakontrolluar të mbetjeve ndikon drejtpërdrejt në imazhin e territorit dhe potencialin e tij zhvillimor.

9. KONKLUZION

Nga analiza rezulton se mos garantimi i shërbimit të pranimi, peshimit dhe depozitimit final të mbetjeve urbane paraqet risk kritik operacional, teknik, mjedisor, shëndetësor, financiar dhe ligjor për Bashkinë Krujë.

Për rrjedhojë, sigurimi i këtij shërbimi përmes procedurave të prokurimit publik përbën një domosdoshmëri funksionale dhe ligjore për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit publik, mbrojtjen e shëndetit publik, ruajtjen e mjedisit dhe përmbushjen e detyrimeve institucionale të Bashkisë Krujë.

GRUPI I HARTIMIT TE DOKUMENATACIONIT TEKNIK: